V E N D I M
Nr.381, datë 12.6.2003

PËR SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 6 të ligjit nr.8811, datë 17.5.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë", me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë përfitojnë një shpërblim në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë, për çdo mbledhje për ushtrimin e funksionit të tyre.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të fillojnë në datën 8.5.2002 dhe të përballohen nga fondet buxhetore të vitit 2003, miratuar për Këshillin e Lartë të Drejtësisë.

3. Ngarkohet Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano